

NJOFTIM
Nr. 4397/1, datë 22.11.2019

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E
“VAKANCËS SË PARAKOHSHME”, TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQITAR NË
GJYKATËN KUSHTETUESE**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pika 3, 179, pika 2, të Kushtetutës, neneve 7, pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit **nr. 32, datë 21.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 387 prot., datë 22.11.2019**, në cilësinë e organit të emërtesës, me qëllim plotësimin e “vakancës së parakohshme”, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, me cilësinë e organit të emërtesës, me **dekretin nr. 11364, datë 22.11.2019**, ka miratuar:

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e “**vakancës së parakohshme**”, të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarit, **z. Besnik Muçi**.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për plotësimin e vakancës së mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës:

- kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (*numër telefoni/ email*);
- fotokopje të kartës së identitetit;
- dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe të nënshkruar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- formulari i vetëdeklarimit është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës;
- formularin e aplikimit, të plotësuar, “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës;
- listën e dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Afati i paraqitjes së kërkesës për shprehjen e interesit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur, është data 20 dhjetor 2019.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikuesve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik.

Lista e aplikuesve dhe dosjet respektive të tyre do t'i përcillen menjëherë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vijimin e procedurës së verifikimit dhe të vlerësimit sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës do të bëjë transparent çdo rezultat të këtij procesi, në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pikat 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune, si: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë e nivelit të dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet, si: gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
- a) vjetërsisë në profesion;
 - b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
 - c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - d) ecuresë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në ambientet e Presidencës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, kodi postar 1001.

Sqarim

Në zbatim të nenit 127, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati që do të përzgjidhet për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vakancës së parakohshme të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit ish-gjyqtarit Besnik Muçi, do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Tiranë, më 22.11.2019.